



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 289/ 2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha, dhe Adnan Konushevc, anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi për ankesat e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli Prishtinë, paraqitur ndaj subjekteve politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Nisma për Kosovën, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Aleanca Kosova e Re (AKR), Alternativa, dhe NDS, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli Prishtinë: ZL Anr. 289/2017, ZL Anr. 290/2017, ZL Anr. 291/2017, ZL Anr. 294/2017, ZL Anr. 297/2017, ZL Anr. 298/2017, ZL Anr. 299/2017, ZL Anr. 300/2017, ZL Anr. 301/2017, ZL Anr. 302/2017, ZL Anr. 303/2017, ZL Anr. 304/2017 ZL Anr. 305/2017 ZL Anr. 307/2017 ZL Anr. 308/2017 ZL Anr. 309/2017 ZL Anr. 310/2017 ZL Anr. 311/2017 ZL Anr. 312/2017 ZL Anr. 313/2017 ZL Anr. 314/2017 ZL Anr. 315/2017 ZL Anr. 317/2017 ZL dhe ZL Anr. 318/2017, të datës 21.10.2017, paraqitur ndaj subjekteve politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Nisma për Kosovën, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Aleanca Kosova e Re (AKR), Alternativa, dhe NDS, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL Anr. 289/2017, ZL Anr. 290/2017, ZL Anr. 291/2017, ZL Anr. 294/2017, ZL Anr. 297/2017, ZL Anr. 298/2017, ZL Anr. 299/2017, ZL Anr. 300/2017, ZL Anr. 301/2017, ZL Anr. 302/2017, ZL Anr. 303/2017, ZL Anr. 304/2017 ZL Anr. 305/2017 ZL Anr. 307/2017 ZL Anr. 308/2017 ZL Anr. 309/2017 ZL Anr. 310/2017 ZL Anr. 311/2017 ZL Anr. 312/2017 ZL Anr. 313/2017 ZL Anr. 314/2017 ZL Anr. 315/2017 ZL Anr. 317/2017 ZL dhe ZL Anr. 318/2017 të datës 21.10.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL Anr. 289/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP, më datë 21.10.2017, ka pranuar ankesat nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli Prishtinë, në të cilat kanë theksuar se:

Ankesa ZL Anr.289/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se Sami Kafexholli kandidat për kryetar të komunës së Malishevës nga LDK ka lejuar që në profilin e tij në facebook të shfaqet postimi i Zenel Hoxhës me fotografi ku kërkohet që të votohet subjekti politik LDK dhe kandidatët e saj.

Ankesa ZL Anr.290/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 rreth orës 09:00 Shukri Quni kandidat i PDK-së ka publikuar një status me përmbajtje që të votohet subjekti politik PDK dhe Shukri Quni.

Ankesa ZL Anr.291/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 Isni Kilaj bartësi i listës së PDK-së, ka shpërndar videon e kandidatit të PDK-së për kryetar të komunës Mursel Gashi.

Ankesa ZL Anr.294/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se, kandidati i Nismës për Kosovën Muhamet Shalaj me datën 21.10.2017 në rrjetin e tij social ka shpërndar statusin duke kërkuar që të votohet subjekti politik Nisma me nr. 31 dhe kandidati Muhamet Shalaj me nr. 4.

Ankesa ZL Anr.297/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 Sabri Gërvalla kandidat i LDK-së ka pranuar profilin e tij në postim nga personi Shpëtim Gërvalla duke kërkuar që të votohet subjekti politik LDK, kandidati Mehmet Krasniqi si dhe kandidati Sabri Gërvalla.

Ankesa ZL Anr.298/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal të Istogut nga AAK Prekë Prekaj ka bërë fushatë duke shpërndar fotot e kandidatit për kryetar të komunës nga AAK Gani Dreshaj dhe duke kërkuar që të votohet nr. 50.

Ankesa ZL Anr.299/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Prishtinë nga LDK Osman Vitija ka shpërndar foto në facebookun e tij kandidatin për kryetar komune në Prishtinë nga LDK-ja Arban Abrashi.

Ankesa ZL Anr.300/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 deputeti nga LVV Fisnik Ismajli në rrjetin e tij social facebook ka aprovuar të shfaqet postimi nga Dren Shahini i cili postim bën thirrje që të votohet Shpend Ahmeti dhe LVV-ja.

Ankesa ZL Anr.301/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidatja për kuvend komunal në Gjilan nga subjekti politik LVV Arbenita Sopi –Haziri ka bërë fushatë duke shpërndar foto në facebook me mbishkrimin për të votuar LVV me nr. 10 dhe nr.e saj 24.

Ankesa ZL Anr.302/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Skenderaj Musa Fazliu nga subjekti politik PDK ka shpërndarë në facebook foton e tij me kryetarin e PDK-së dhe duke ju bërë të ditur qytetareve se si të votohet nr. i tij 17.

Ankesa ZL Anr.303/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Skenderaj Rasim Shala nga subjekti politik PDK ka shfaqur ose ka konfirmuar të shfaqet një fotografi me logon dhe numrin e partisë së tij.

Ankesa ZL Anr.304/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Skenderaj Ilir Ejupi nga subjekti politik PDK ka shperndar foto në facebookin e tij duke kërkuar që të votohet PDK me nr 94 dhe Ilir Ejupi me nr.14

Ankesa ZL Anr.305/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidatja për kuvend komunal në Prizren Dafina Bllaca nga subjekti politik PDK ka shperndar foto në facebookin e saj duke kërkuar që të votohet PDK nr 94 Shaqir Totaj dhe Dafina Bllaca nr 24

Ankesa ZL Anr.307/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Prizren Ilir Baldedaj nga subjekti politik AAK duke njoftuar se si të votohet ai me nr. 7 dhe AAK me nr. 50.

Ankesa ZL Anr.308/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Prishtinë Vesel Makolli nga subjekti politik AKR ka shperndarë foto në facebookin e tij të kandidatit për kryetar të komunës së Prishtinës nga AKR Selim Pacolli dhe mbishkrimin “bashkohet Gollaku për Selim Pacollin me AKR 34”.

Ankesa ZL Anr.309/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidatja për kuvend komunal në Prizren Lirije Kukaj Buzhala nga subjekti politik LDK ka shperndarë postimin në facebookin e saj të kandidatit të LDK për kryetar komune Hatim Baxhaku dhe duke kërkuar që të votohet ai dhe LDK-ja

Ankesa ZL Anr.310/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidatja për kuvend komunal në Mitrovicë Edona Shabani nga subjekti politik Alternativa ka shperndarë foton e saj në facebook dhe duke kërkuar që të votohet nr. 30 Alternativa në Mitrovicë dhe Edona Shabani nr 10

Ankesa ZL Anr.311/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Pejë Labinot Panxha nga subjekti politik AAK ka shperndar foto në facebookin e tij duke kërkuar që të votohet nr. 13 dhe Fatmir Gashi me nr. 50 nga AAK-ja

Ankesa ZL Anr.312/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Prizren Sadri Hodaj nga subjekti politik LVV në rrjetin e tij social facebook ka shperndar një status në të cilën kërkohet që të votohet subjekti politik LVV

Ankesa ZL Anr.313/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidati për kuvend komunal në Prizren

Sebajdin Shabani nga subjekti politik LVV ka shpërndarë foto në facebokin e tij duke kërkuar që të votohet ai.

Ankesa ZL Anr.314/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidatja për kryetare të Komunës së Prizrenit nga subjekti politik VAKAT Emilija Rexhepi ka shpërndarë foto në facebokin e saj duke kërkuar që të votohet emri i saj Emilija Rexhepi NDS 64.

Ankesa ZL Anr.315/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 bartësi i listës për kuvend komunal në Pejë Beqir Kajtazi nga subjekti politik AAK ka shpërndarë video të fushatës politike të AAK-së.

Ankesa ZL Anr.317/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 dega e PDK-së në Podujevë ka shpërndarë video të fushatës zgjedhore ku bëhet thirrje për ta votuar nr. 94 dhe Hajredin Hysenin nga PDK-ja.

Ankesa ZL Anr.318/2017, është e parashtruar nga BIRN dhe INTERSNEWS KOSOVA, me të cilën pretendohet se me datën 21.10.2017 kandidatja për kuvend komunal në Podujevë Dafina Jaha nga subjekti politik LVV ka shpërndarë foto me emrin dhe numrin e saj në të cilin garon ajo.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve në ankimore në ankesa nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesat e parashtruara, në kuptim të nenit 117 par 3 të LZP-së ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjat vendosjes së ankesave i shqyrton dhe i hetoi me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesa dhe kurë vlerëson se pretendimet nuk janë mirë të bazuara në fakte dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore ankesat e tilla i refuzon.

Paneli vlerësoj se ankesat e parashtruar nga parashtruesi i ankesave nuk i plotësojnë këto standarde ligjore. Kjo për faktin se nga prova e ofruar në ankesa paneli nuk pati mundësi të vërtetojë në mënyrë bindëse dhe të qartë se postime e shkelësve të supozuar janë publikuar në facebook, në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 21.10.2017, ashtu si pretendohet në ankesa, kjo për faktin se, në fotografit e bashkangjitura në ankesa nuk ekziston data dhe ora e postimit se të njëjtat janë postuar dhe publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 21.10.2017.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL Anr. 289/2017 më datën 22.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Gytene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.